



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 8 të Udhëzimit administrativ nr. 01/2015, për transparencë në komuna, nenit 32, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më, 22.03.2018 miratoi këtë

V E N D I M
PËR KONSULTA PARAPRAKE PUBLIKE

I.

Miratohet Vendimi për dërgimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës, në konsulta paraprake publike.

II.

Komisioni lidhur me vendimin e cekur në pikën I, do të ofrojë informata të nevojshme për opinionin - qytetarët e interesuar, përmes formave të fushatave informative, kontakteve me grupe të interesit dhe palët e interesuara për t'i diskutuar propozimet.

III.

Konsultat paraprake publike për rregulloren e cekur në pikën I të këtij vendimi, do të zgjatin 15 ditë.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përgjegjëse.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-330/02-70160/18, më 23.03.2018



KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta